



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 164 , Datë 31.07.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 258, DATË 21.12.2021,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 1368/3 prot., datë 24.07.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, i ndryshuar”.

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “YILDRIM ENERFY EUROPE ALBANIA” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 258, datë 21.12.2021, ka licencuar shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. (në atë kohë e identifikuar me emrin “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Në këtë vendim janë vendosur një sërë detyrimesh për shoqërinë, përfshirë: depozitimin e strukturës së ndërtimit dhe funksionimit administrativ (pika 2 – tashmë e shfuqizuar me vendimin nr. 68, datë 03.03.2023), depozitimin e sistemit IT me fillimin e operimit (pika 3), depozitimin e kontratës së huapërdorjes të rinovuar jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit data 01.02.2024) (pika 4).

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të kushteve të licencimit, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1368 prot., datë 18.03.2025, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me plotësimin e pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit nr. 258/2021, i ndryshuar.
- Duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk është kryer raportim periodik dhe nuk është kthyer përgjigje në lidhje me përmbushjen e kushteve të vendimit të licencimit, ERE i është drejtuar sërish me shkresën nr. 1368/1 prot., datë 14.05.2025, duke i rikujtuar detyrimet që shoqëria ka në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar.

- Shoqëria me shkresën nr. 1368/2 prot., datë 28.05.2025, në kuadër të pikës 3 të vendimit të licencimit ka deklaruar se nuk e ushtron ende veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike. Në lidhje me sistemin IT dhe realizimin e procesit të faturimit sqaron se është në proces negociimi e në momentin e mbylljes së marrëveshjes do ta përcjellë atë në ERE.
- Në kuadër të plotësimit të pikës 4, shoqëria ka depozituar në ERE amendimin e kontratës së nënqirasë, të lidhur më datë 01.02.2024. Palët kanë rënë dakord që afati i kontratës, i cili përfundon më datë 01.02.2026, të zgjatet edhe me një vit, duke përfunduar më datë 01.02.2027.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me vendimin nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar, detyrimi për dorëzimin e sistemit IT mbetet në fuqi dhe, deri më tani, nuk është përmbushur. Kjo, pasi shoqëria nuk ka filluar ende ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike dhe nuk ka paraqitur informacion apo dokumentacion mbi sistemin e planifikuar IT. Shoqëria ka shprehur gatishmërinë për ta depozituar dokumentacionin përkatës pranë ERE-s pas përfundimit të procesit të negociimit.
- Lidhur me detyrimin për raportim periodik mujor, të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 68, datë 03.03.2023, dhe në pikën 3 të vendimit nr. 258, datë 21.12.2021, shoqëria ka vijuar të raportojë në mënyrë të vazhdueshme mbi statusin e veprimtarisë së saj, duke deklaruar se aktiviteti nuk është ende i nisur.
- Për sa i përket detyrimit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të licencimit, shoqëria ka përmbushur këtë kusht, duke depozituar pranë ERE-s amendimin e kontratës së nënqirasë të lidhur më datë 01.02.2024.
- Me depozitimin e kontratës së mësipërme, shoqëria ka përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 4 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar. Duke qenë se kontrata është në fuqi deri më datë 01.02.2027 dhe mbulon gjithë periudhën e mbetur të licencës (deri më 21.12.2026), vlerësohet që pika 4 e vendimit të licencimit të shfuqizohet si e përmbushur.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. e ka përmbushur kushtin përkatës të përcaktuar në këtë pikë.
- Duke qenë se shoqëria ende nuk ka filluar operimin në veprimtarinë e licencuar dhe për rrjedhojë, raportimi periodik mujor nuk ka objekt zbatimi praktik, vlerësohet e arsyeshme shfuqizimi i këtij detyrimi. Në të njëjtën kohë, vlerësohet të mbetet në fuqi detyrimi për depozitimin e sistemit IT pranë ERE-s, sipas përcaktimeve të pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar, si më poshtë “2. Me fillimin e operimit, shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE sistemin IT.”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, i ndryshuar, si më poshtë: *“2. Me fillimin e operimit, shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE sistemin IT.”.*
2. Të shfuqizojë pikën 4 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, i ndryshuar.
3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI